

# Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

## Shtator 2017


**Tiranë, më 23 Tetor 2017:** Numri i shtetasve shqiptarë dhe të huaj të hyrë në territorin shqiptar, në muajin Shtator 2017 është 852.743. Krahasuar me Shtator 2016, ky tregues rezulton me rritje 8,8 %.

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vend është 459.168, krahasuar me Shtator 2016, ky numër është rritur me 12,9 %. Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vendin tonë në nëntëmujorin e 2017 është 4.224.683, duke u rritur me 5,7 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2016.

Në Shtator 2017, ndër dhjetë vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, ato nga Zvicra kanë pësuar rritjen më të madhe me 115,8 %, ndërsa uljen më të madhe e kanë patur shtetasit nga SHBA me 21,8 %.

Në nëntëmujorin e 2017, ndër dhjetë vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, rritja më e madhe e hyrjeve ka ardhur nga Polonia me 65,6 % dhe rënie kanë patur vetëm hyrjet nga Kosova me 22,1 %. (shih tab 2.)

**Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri**



Shtetasit shqiptarë dhe të huaj të dalë nga vendi, gjatë muajit Shtator 2017, janë 1.053.181, duke shënuar një rritje me 11,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Shtator 2017, është 498.678.

**Për publikim 23/10/2017**

Krahasuar me Shtator 2016, ky numër është rritur 6,3 %. Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i vendit tonë në nëntëmujorin e 2017 është 3.937.855, duke u rritur 5,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Hyrjet e shtetasve të huaj dhe shqiptarë në muajin Shtator 2017, në rrugë tokësore zënë peshën më të madhe të hyrjeve gjithsej me 79,1 %, ndërsa hyrjet në rrugë ajrore zënë 13,3% dhe detare zënë 7,6 %.

**Tab.1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj**

Periudha	Shtator-16	Shtator-17	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Shtator 16	Janar-Shtator 17	Ndryshimi vjetor progresive (%)
<b>Hyrje Gjithsej</b>	<b>783.544</b>	<b>852.743</b>	8,8	<b>7.416.181</b>	<b>7.803.037</b>	5,2
Shqiptarë	376.962	393.575	4,4	3.419.571	3.578.354	4,6
Të Huaj	406.582	459.168	12,9	3.996.610	4.224.683	5,7
<b>Dalje Gjithsej</b>	<b>946.766</b>	<b>1.053.181</b>	11,2	<b>7.697.978</b>	<b>8.225.250</b>	6,8
Shqiptarë	469.093	498.678	6,3	3.728.769	3.937.855	5,6
Të Huaj	477.673	554.503	16,1	3.969.209	4.287.395	8,0

**Tab.2 Hyrjet e shtetasve të huaj**

Shtetet	Shtator-16	Shtator-17	Ndryshim mujor në %	Janar-Shtator 16	Janar-Shtator 17	Ndryshim vjetor në %
Kosovë	168.398	159.731	-5,1	1.930.134	1.503.594	-22,1
Maqedoni	47.273	56.720	20,0	456.187	510.001	11,8
Greqi	32.093	40.803	27,1	305.869	351.464	14,9
Itali	21.599	28.122	30,2	200.194	294.447	47,1
Angli	10.747	11.135	3,6	81.754	111.418	36,3
Mali i zi	21.059	37.650	78,8	249.583	290.259	16,3
Poloni	12.239	14.765	20,6	62.879	104.143	65,6
SHBA	9.744	7.616	-21,8	67.906	84.462	24,4
Gjermani	10.160	13.059	28,5	67.630	101.807	50,5
Zvicër	1.567	3.381	115,8	31.274	49.032	56,8
Të tjera	71.703	86.186	20,2	543.200	824.056	51,7
<b>Gjithsej</b>	<b>406.582</b>	<b>459.168</b>	12,9	<b>3.996.610</b>	<b>4.224.683</b>	5,7

**Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit**

Periudha	Shtator-16	Shtator-17	Janar-Shtator 16	Janar-Shtator 17
<b>Hyrje Shtetas të Huaj</b>	406.582	459.168	3.996.610	4.224.683
I. Personale	400.737	452.634	3.953.323	4.172.776
1. Pushime	214.810	188.266	1.767.310	2.094.930
2. Vizitë në miq e të afërm	858	2.927	15.471	15.651
3. Vizitë ditore	25.313	74.289	473.129	239.830
4. Trajtim shëndetësor	49	61	499	378
5. Qëllime fetare	63	25	751	487
6. Vizitorë të tjerë	148.414	171.703	1.571.660	1.678.931
7. Udhëtarë tranzit	11.230	15.363	124.503	142.569
II. Biznes dhe profesionale	5.845	6.534	43.287	51.907

**Tab.4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit**

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Shtator - 16	93.080	52.373	638.091	120.571	122.689	703.506
Shtator - 17	113.508	64.516	674.719	151.803	108.681	792.697
Ndryshimi vjetor (%)	21,9	23,2	5,7	25,9	-11,4	12,7
Janar-Shtator 2016	809.236	524.875	6.082.070	798.805	596.362	6.302.811
Janar-Shtator 2017	989.749	639.358	6.173.930	1.012.416	689.396	6.523.438
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	22,3	21,8	1,5	26,7	15,6	3,5

# Metodologji

## Përkufizime

**Vizitorë:** Për qëllime të statistikës së turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

**Hyrjet:** Përfshijnë të gjitha hyrjet në kufi.

Hyrjet është një koncept që i referohet të gjitha arritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

**Daljet :** Përfshijnë të gjitha daljet në kufi. Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës.

Qëllimi kryesor i vizitës është qëllimi pa të cilën udhëtimi nuk do të kryhej. Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për arsye:

Vizitat për *qëllime personale*

1. Pushime
2. Vizitë në miq e të afërm
3. Vizitë ditore
4. Trajtim shëndetësor
5. Qëllime fetare
6. Vizitorë të tjerë
7. Udhëtarë tranzit

*Kategoria e biznesit* përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

**Burimi i të dhënave:** Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme (Drejtoria e Policisë së Shtetit).

Të dhënat e muajit të fundit janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/>